



---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI  
KRYETARI

Nr. 1330/prot.  
/3

Tiranë, më 30.06.2021

**Lënda:** Miratimi i ndryshimeve në Rregulloren për akreditimin, akomodimin dhe orientimin e masmedieve pranë Kuvendit të Shqipërisë

**Drejtar:** Byrosë së Kuvendit

*Të nderuar deputetë,*

Pas miratimit të Rregullores së akreditimit të medies në Byro, në vëndimin nr. \_\_\_\_\_, datë **02.06.2021**, pati disa reagime nga përfaqësues të medias, lidhur me përcaktimet në Rregulloren e re, kryesisht përsa i takon aksesit të tyre në ambientet e Kryesisë së Kuvendit.

Nisur nga këto reagime në shtyp dhe jo vetëm, në datë 11 Qershor, në ambientet e Kryesisë së Kuvendit, u zhvillua një tryezë diskutimi me përfaqësues të medias, lidhur me ndryshimet e fundit të Rregullores, si dhe ndryshimet e reja që ka pësuar sistemi audio-video i transmetimit të mbledhjeve të komisioneve parlamentare. Në takim morën pjesë përfaqësues nga Unioni i Gazetarëve Shqiptarë, gazetarë të akredituar në Kuvend, si edhe përfaqësues të tjerë të medias.

Në këtë takim, gazetarët u njohtën me arsyet dhe nevojën e krijimit të një sistemi të ri audio-video, pasi komisionet parlamentare prej vitesh kanë pasur mangësi në regjistrimin dhe dokumentimin e mbledhjeve për shkak të teknologjisë së vjetëruar. Në kuadër edhe të rekondimeve të Progres-Raporteve të Komisionit European për Shqipërinë të viteve 2013-2014, të cilët kishin theksuar nevojën e rritjes së transparencës dhe përfshirjes së shoqërisë civile në procesin legjislativ, si edhe përmirësimit të informimit të publikut mbi aktivitetet parlamentare dhe dokumentacionin parlamentar, u vlerësua e nevojshme që të ndërtohej një sistem i ri audio-video.

Gjithashtu të pranishmit u sqaruan se reflektimet në ndërhyrjet e reja në Rregulloren e Kuvendit dhe në Rregulloren e Masmedias, thelbësish, nuk shtojnë asnjë ndalesë të re lidhur me hapësirat e lejuara për punonjësit e akredituar të medias, krahasuar me Rregulloren e mëparshme dhe gjithashtu se ky sistem ka në vëmendje transparencën maksimale për gazetarët dhe publikun, kushtet e tyre të punës dhe seriozitetin e Kuvendit të Shqipërisë.

Përfaqësuesit e medias paraqitën shqetësimet e tyre lidhur me ndryshimet e reja në Rregulloren e Masmedias dhe kërkuan rishikim të disa prej pikave të saj që lidhen me: lejimin e prezencës fizike të gazetarëve në komisionet parlamentare; mundësimin e marries së planeve video për një minutazh të caktuar; lejimin e përdorimit të aparateve celularë në ambientet e komisioneve; moshoqërimin nga shërbimet e sigurisë dhe zyra përgjegjëse për mediat e institucionit; lejimin e lëvizjes për gazetarët dhe punonjësit e medias edhe në ambientet e tjera, përtej atyre që përcaktohen në Rregullore.

Në përfundim të takimit, Sekretari i Përgjithshëm i siguroi të pranishmit që kërkesat e tyre do t'i paraqiten për shqyrtim Kryetarit të Kuvendit dhe Byrosë.

Në vijim të këtij takimi me gazetarët, u zhvilluan edhe disa takime të tjera, me qëllim konsultimin e ndryshimeve të mundshme në Rregulloren e akreditimit të masmedies, referuar edhe kërkesave të gazetarëve për ndryshime në këtë Rregullore.

Takime konsultative u zhvilluan me punonjësit e Zyrës së Shtypit në Kuvend, Kryetarin dhe Nënkyryetaren e Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik dhe Grupet Parlamentare.

Pas zhvillimit të këtyre takimeve, vlerësova t'Ju paraqes sugjerimet si më poshtë:

1. Lidhur me kërkesën për lejimin e prezencës fizike të gazetarëve në komisionet parlamentare si dhe lejimin e përdorimit të aparateve celularë në ambientet e komisioneve nga ana e tyre, **kjo kërkesë të merret në konsideratë**, duke u mundësuar atyre aksesin e plotë të cdo informacioni, përtej asaj që mundëson sistemi.
2. Lidhur me kërkesën për mundësimin e marrjes së planeve video për një minutazh të caktuar, **edhe kjo kërkesë të merret në konsideratë**, duke përcaktuar një kohë në dispozicion për marrjen e këtyre planeve, rreth 5 minuta nga fillimi i mbledhjes.
3. Lidhur me kërkesën për mosshoqërimin nga shërbimet e sigurisë dhe zyra përgjegjëse për mediat, në ambientet e Kryesise së Kuvendit, sugjerojmë të merret në konsideratë kjo kërkesë, përsa i takon pjesës së mosshoqërimit nga ana e punonjësve të sigurisë, duke përcaktuar mundësine e shoqërimit të përfaqësuesve të medies vetëm nga ana e **punonjësve të Zvrës së Shtypit në Kuvend**, në rastet kur është e nevojshme, dhe sipas përcaktimeve të lëvizjes dhe vendqëndrimit të tyre në këtë Rregullore.
4. Lidhur me kërkesën për lejimin e lëvizjes për gazetarët dhe punonjësit e medias edhe në ambientet e tjera (intervistat me kamera në korridore), përtej atyre që përcaktohen në Rregullore, sugjerojmë që **kjo kërkesë të merret pjesërisht në konsideratë**, duke ndaluar qëndrimin e tyre në korridoret e brendshme të godinës së Kryesisë së Kuvendit, por njëkohësisht duke ju krijuar atyre një ambjent të posaçëm qëndrimi, përvèç atij te salla e medias/*News Room*, edhe në oborrin e jashtëm, brenda territorit të Kryesisë së Kuvendit, duke mundësuar në këtë mënyrë aksesin e tyre ndaj deputetëve dhe personave të tjera për të cilët janë të interesuar.
5. Lidhur me kërkesën e fundit, për heqjen e detyrimit për dhënie informacioni lidhur me çështjet konkrete që do të diskutohen, në kërkesat për intervista me deputetë në Kuvend, **sugjerojmë që kjo kërkesë të merret në konsideratë**, duke e vlerësuar si të panevojshëm detyrimin e tyre për të informuar Zyrën e Shtypit lidhur me çështjet konkrete të intervistës.

Ju faleminderit për vëmëndjen.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KUVENDI  
*Byroja*

PROJEKT VENDIM  
Nr. \_\_\_, datë \_\_\_\_\_.2021

**PËR DISA NDRYSHIME NË RREGULLOREN PËR AKREDITIMIN, AKOMODIMIN DHE  
ORIENTIMIN E MASMEDIEVE PRANË KUVENDIT TË SHQIPËRISË**

Mbështetur në Regulloren e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, neni 105 pika 4 , me propozim të Sekretarit të Përgjithshëm, Byroja e Kuvendit në mbledhjen e saj të datës \_\_\_\_\_.2021,

**VENDOSI:**

1. Miratimin e ndryshimeve në “Rregulloren per akreditimin, akomodimin dhe orientimin e masmedieve pranë Kuvendit të Shqiperisë” sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI**

---

**Gramoz RUÇI**

## **“PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË RREGULLOREN PËR AKREDITIMIN, AKOMODIMIN DHE ORIENTIMIN E MASMEDIEVE PRANË KUVENDIT TË SHQIPËRISË”**

Në zbatim të nenit 105 pika 4, Byroja e Kuvendit me propozim të Sekretarit të Përgjithshëm, në mbledhjen e datës \_\_\_/\_\_\_/2021,

### **VENDOSI**

Në Rregulloren për akreditimin, akomodimin dhe orientimin e masmedieve pranë Kuvendit të Shqiperisë, bëhen shtesat dhe ndryshimet si më poshtë:

1. Neni 12, pika 1 ndryshohet dhe bëhet:

“Te Kryesia e Kuvendit në Neës Room/ Salla e Gazetarëve, që ndodhet në katin e parë të godinës si dhe në ambientin e cakuar për ta që ndodhet ne oborrin brenda territorit te Kryesisë së Kuvendit”.

2. Neni 16 ndryshohet dhe bëhet :

“Përfaqësues nga Zyra e Shtypit pranë Kuvendit, shoqëron persona e akredituar gjatë qëndrimit të tyre ne Kuvend, kur është e nevojshme dhe sipas përcaktiveve të kësaj Rregullore.

3. Te Neni 17, pika 2, pas gërmës b), te shtohet një pikë:

“c) ne ambientet e sallave te komisioneve (por jo te qëndrojne në korridore) përgjatë zhvillimit te mbledhjeve te komisioneve parlamentare dhe mund te jene te paisur edhe me aparatet e tyre celular.

4. Te Neni 18, pas pikës 1, të shtohet një pikë si më poshtë:

Pika 2 “Kuvendi siguron për mediet, marrjen e planeve me kamerat e tyre, në fillimin e mbljedhjes së komisioneve parlamentare, për një periudhe kohore deri në 5 min, nga hapja e mbledhjes. Pas marrjes së planeve , operatorët shoqërohen nga punonjësit e zyrës së Shtypit për në ambientet e përcaktuara për ta në Kryesinë e Kuvendit”.

5. Neni 29, pika 1, ndryshohet dhe bëhet :

“Organizimi i intervistave zhvillohet, pasi vihet ne dijeni Zyra e Shtypit në Kuvend, nga personat e akredituar”.

6. Neni 29, pika 2 hiqet fare.